


Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupstina Opstine
Municipal Assambly

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ne baze te rregullores MF-Nr 04/2017 mbi kriteret ,Standartet dhe Programet e financimit publik te OJQ-ve

Fton

Të gjitha Organizatat Jo Qeveritare Rinore që veprojnë ne Komunën e Istogut të aplikojnë me projekt-propozim:

1. Për organizimin e aktiviteteve për nder te bashkatdhetarëve.

Në projekt duhet të janë të përshkruara qartë objektivat, aktivitetet sa me të detalizuara , përfituesit dhe buxheti.

Projekti duhet te jete sa me i specifikuar ne përshkrim elektronik ,pra te ceken në detale aktivitetet kulturore te cilat do te organizohen për nder te bashkatdhetarëve .

Te gjitha aktivitetet - agjenda e parapara duhet te përpilohet ne bashkëpunim me Drejtorin e për Arsim dhe Kulturë.

Përparësi do te kenë këto Organizata qe :

1. Qe kane bashkëpunim me një apo më shumë organizata qe merren me aktivite te tilla .
2. Organizatat qe kane dëshmi për aktivite te tilla.
3. Përparësi do te kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qarte dhe buxhetin e specifikuar.

Projekt propozimi i dorëzuar duhet te përmbaje :

- Ne projekte duhet te përfshije lokacionin,kohëzgjatjen e implementimit,numrin e aktiviteteve Kulturore etj.
- Projekt propozimi duhet te jete i kufizuar deri në 1000 euro.
- Një kopje qe posedon regjistrimin e OJQ - së,kopjen e certifikatës fiskale

- Një kopje të llogarisë bankare të OJQ-së dhe kopjen e letërnjoftimit të menaxherit të projektit.
- Projektet nuk do të përkrahen nëse nuk kanë përputhshmëri me kriteret e kësaj thirrje .

Projekt - propozimet do të vlerësohen nga një komision në përbërje prej pesë anëtarëve .

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 17.08.2018.
Projektet që aplikojnë pas këtij termini nuk do të shqyrtohen. Projektet duhet të dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar Nr 100.

**Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport
z. Drin Sadikaj**

